



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/02-18997
Dt. 09.09.2020

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	ARIF (HAXHI) MORINA nga Gjakova		
Rruga:	"Dëshmorët e Lirisë" pn.		
Telefoni:	044 178 981	Emaili:	

Emri i Projektit:	Objekt i kategorisë së parë me destinim, shtëpi banimi individuale , me etazhitet P+1		
Emri i Projektuesit:	Ndërmarrja projektuese ndërtimore "EKO-ARK" Sh.p.k		
Adresa:	Rruga " Mithat Frashëri " nr.155 - Gjakovë		
Telefoni:	044 122 414	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: "Dëshmorët e Lirisë" pn.		
Zona(t) Kadastrale: Gjako – Qytet	Nr. i parceles kadastrale: 3271-12	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II <input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i objektit të kategorisë së parë me destinim – shtëpi banimi individuale , me etazhitet P+1.	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore: **Arif (Haxhi) Morina nga Gjakova**, i lejohet ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi banimi individuale, me etazhitet P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit për ndërtim **S=190.00m²**.

Përdhesa: (Sip,Bruto): S= 95.00 m²
Kati i parë: (Sip,Bruto): S= 95.00 m²

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.



Arsyetim

Aplikuesi: **Arif (Haxhi) Morina nga Gjakova**, me banim në rrugën “Dëshmorët Lirisë” pn, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-18997, të datës 31.08.2020, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare me etazhitet P+1, në ngastren kadastrale me numër **3271-12, ZK: Gjakovë- Qytet**, në pronësi të lartpërmendurit..

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 23.07.2020, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
- Kopjen e planit të datës 05.06.2020 (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 1132/20, të datës 05.06.2020, në pronësi të **Arif (Haxhi) Morina** nga Gjakova të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Vërtetimi mbi tatimin ne prone nr. 430-B-255 të datës 05.06.2020.
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 4/525, dt. 06.08.2020.
- Pëlqimin nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, nr.1281 të datës 27.07.2020.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, të datës 24.07.2020.
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në IFJB-Capital filiali në Gjakovë me datë 03.09.2020.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga Ndërmarrja projektuese “EKO-ARK” Sh.p.k - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej : 893.62 Euro

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës 23.07.2020 të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për Punë Inspektuese,**
- **Arkivit.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike



Zenel Shabani, jur. i dipl.



K.K. GJAKOVË
Z.K. : Gj. Qytet
Ng. nr. 3271-12

PLAN SITUACIONI

LOKACIONI : ARIF (HAXHI) MORINA
ETAZHITETI : P+1
DIMENSIONET : 10.00m x 10.00 - 9.00m
SIPËRFAQJA E OBJEKTIT NË PËRÐHESE: $S = 96.00m^2$
LARTËSIA E ETAZHEVE (dysHEME-dysHEME) : $H=2.80m$
HAPJET: Lejohen hapje të dimensioneve standarde në anën jugore dhe perendimore, ndërsa në anën lindore dhe veriore ku objekti do të ndërtohet 1.0m i larguar nga kufiri kadastral me parcelat fqinje lejohen hapje me parapet 1.60m nga kuota e dyshemesë
KULMI: mund të ketë derdhje të ujrave në të gjitha drejtimet varësisht prej zgjidhjes së projektantit



Gjendja faktike
Gjendja kadastrale

Lokacioni sipas Planit Rregullues të Hollsishëm, potezi përgjat rrugës "Dëshmorët e Lirisë" për ndërtimin e objektit të kategoris I-rë me karakter banim individual-shtëpi familjare, me etazhitet P+1, në parcelën ndërtimore P-70705029-03271-12 Z.K. Gjakovë- qytet, vendosur sipas kërkesës për Kushte të Ndërtimit me nr. 07-351/01-11837 të dt. 05.06.2020.

Gjakovë
Dt. 23.07.2020

Punoi:
Fatmir Bobi tek. gjeod.

Kontrolloi:
Durrrije Berisha inxh. dip. ark.

15.06.2020
GPS
Auto CAD 2004

P = 1 : 500

Vërtetoi : N.P.SH."GELI"
DREJTORI

Punoi : *Rhodan F. Zhubi, inxh. dipl. i gjeod.*

Frok Hajdaraj